KONVENTA KOMBËTARE PËR BASHKIMIN EVROPIAN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT (KKBE-MK)

SESIONI I 16-TË I GRUPIT TË PUNËS 3 – GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE – KAPITULLI I 23-TË "KONTRIBUTI FRANCEZ NË SUNDIMIN E TË DREJTËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT"

TEMA: "SHTIGJET DREJT INTEGRITETIT DHE PAVARËSISË SË GJYQËSORIT: NJË SFIDË KRYESORE NË REFORMAT E SUNDIMIT TË SË DREJTËS DHE LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT"

REKOMANDIME

I. REKOMANDIME PËR FORCIMIN E INTEGRITETIT NË GJYQËSORIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

1. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të shqyrtojnë mundësinë e vendosjes së një sistemi të detyrueshëm të vetëvlerësimit vjetor të gjykatave dhe prokurorive publike, me qëllim avancimin e integritetit institucional, transparencës dhe llogaridhënies. Për këtë qëllim, të inicohet përgatitja e një metodologjie të unifikuar dhe e një mekanizmi për koordinimin dhe monitorimin e rezultateve, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këshillave gjyqësorë dhe prokurorialë, komunitetit akademik dhe organizatave të shoqërisë civile, duke marrë parasysh parimet e përcaktuara në nenin 11 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.

2. Ministria e Drejtësisë, në kuadër të grupeve të punës për ndryshimin e ligjeve që rregullojnë funksionimin e gjyqësorit dhe Prokurorisë Publike, të inicojë përcaktimin më të saktë të bazave dhe procedurave për konstatimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, veçanërisht në rastet e veprimit të njëanshëm, konfliktit të interesit dhe shkeljeve të rënda të standardeve etike. Zgjidhjet ligjore duhet të përcaktojnë kritere të qarta për dallimin ndërmjet shkeljeve etike dhe atyre disiplinore, proporcionalitetin e sanksioneve, të drejtën për mbrojtje dhe të drejtën për mjet juridik efektiv. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të sigurojnë publikimin e rregullt dhe në kohë të vendimeve përfundimtare për konstatimin e përgjegjësisë disiplinore, me arsyetimin përkatës, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe publikimin periodik të të dhënave të përmbledhura për procedurat e iniciuara dhe të përfunduara, llojet e shkeljeve dhe masat e shqiptuara.

3. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor dhe institucionet kompetente gjyqësore, të inicojë avancimin e Portalit ekzistues Gjyqësor, me qëllim sigurimin e publikimit të rregullt, në kohë dhe të standardizuar të vendimeve gjyqësore, duke përfshirë edhe vendimet e shkallës së parë që nuk kanë marrë formë të prerë, me shënimin e qartë të statusit të tyre juridik dhe respektimin e kufizimeve ligjore lidhur me publikimin e tyre. Për këtë qëllim, të përcaktohen rregulla të unifikuara për anonimizimin dhe publikimin e vendimeve, si dhe të krijohet një sistem funksional për kërkimin e tyre sipas gjykatës, llojit të lëndës, fushës juridike, datës dhe statusit të formës së prerë. Gjithashtu, të përgatitet një plan për avancimin teknik të portalit, i cili do të përfshijë vlerësimin e mjeteve financiare të nevojshme, burimet e financimit, afatet kohore dhe përgjegjësitë institucionale. Të vendoset gjithashtu një mekanizëm për monitorimin periodik dhe raportimin publik lidhur me rregullsinë dhe plotësinë e publikimit të vendimeve gjyqësore.

4. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me institucionet kompetente të drejtësisë, të sigurojë zbatimin konsekuent të vlerësimit paraprak të ndikimit të rregullativës (ex-ante evaluation) gjatë përgatitjes së ligjeve të reja dhe ndryshimeve ligjore në fushën e drejtësisë. Vlerësimi duhet të përfshijë analizën e efekteve të pritshme mbi sigurinë juridike, harmonizimin e praktikës gjyqësore, kapacitetet institucionale dhe kostot e zbatimit. Rezultatet e vlerësimit duhet të jenë publikisht të qasshme dhe t'i nënshtrohen konsultimeve me gjyqtarët, prokurorët publikë, komunitetin akademik dhe organizatat e shoqërisë civile, ndërsa rreziqet dhe nevojat e identifikuara duhet të merren parasysh gjatë hartimit të zgjidhjeve ligjore dhe planifikimit të zbatimit të tyre.

5.Prokuroria Publike të sigurojë ushtrimin më aktiv dhe transparent të kompetencave të Personit për Integritet dhe Këshillit të Etikës, të përcaktuara me Kodin e Etikës së Prokurorëve Publikë. Personi për Integritet duhet ta forcojë rolin e tij parandalues dhe këshillëdhënës përmes dhënies së udhëzimeve dhe mendimeve lidhur me dilemat etike dhe rreziqet që burojnë nga konflikti i interesit, ndërsa Këshilli i Etikës duhet të publikojë rregullisht qëndrime dhe mendime të arsyetuara lidhur me zbatimin e standardeve etike, duke respektuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në bazë të problemeve të identifikuara gjatë zbatimit të Kodit, të përgatiten analiza periodike dhe rekomandime për masa parandaluese dhe trajnime të specializuara për prokurorët publikë.

II. PROPOZIME PËR NDRYSHIME NË LIGJIN PËR AKADEMINË E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE PUBLIKË

Gjatë zbatimit të deritanishëm të Ligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë janë identifikuar disa mangësi normative dhe praktike që ndikojnë në efikasitetin e funksionimit të saj, veçanërisht në procedurën e pranimit të kandidatëve dhe realizimin e trajnimit fillestar. Për këtë arsye, paraqitet nevoja për rishqyrtimin dhe ndryshimin e duhur të dispozitave të Kapitullit IV – Trajnimi i kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, me qëllim tejkalimin e mangësive të konstatuara.

1. Bordi Drejtues i Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, pas përcaktimit nga këshillat kompetentë të numrit të vendeve të lira dhe nevojave kadrovike sipas rajoneve të apelit, të miratojë një plan vjetor për pranimin dhe trajnimin fillestar të kandidatëve, me afate të përcaktuara qartë për shpalljen e konkursit, zhvillimin e provimit pranues, përzgjedhjen e kandidatëve dhe fillimin e trajnimit. Plani duhet të sigurojë përfundimin në kohë të procedurës së pranimit dhe fillimin e rregullt të trajnimit fillestar më 1 shtator, me qëllim shmangien e vonesave në përgatitjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj publikë.

2. Ministria e Drejtësisë të inicojë ndryshime në dispozitat ligjore që rregullojnë pranimin në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, me të cilat do të hiqet kushti për së paku dy vjet përvojë pune pas dhënies së provimit të jurisprudencës, si dhe do të hiqen nga procedura e pranimit testi i njohjes së gjuhës së huaj, testi psikologjik dhe testi i integritetit. Mësimi i gjuhës së huaj të bëhet pjesë përbërëse e trajnimit fillestar, ndërsa njohuritë e fituara të verifikohen në provimin përfundimtar. Vlerësimi psikologjik dhe verifikimi i integritetit të zhvendosen në fazën e përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, nën kompetencën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Gjatë rishikimit të kushteve për pranim, të shqyrtohet edhe arsyeshmëria e vendosjes eventuale të një kufiri moshe, në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit.

3. Ministria e Drejtësisë të inicojë ndryshime në nenin 34 të Ligjit për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, me të cilat do të përcaktohet kohëzgjatja e detyrueshme e mësimit përgatitor prej së paku pesë ditësh pune, i cili duhet të fillojë së paku 45 ditë para mbajtjes së provimit pranues. Akademia të sigurojë publikimin në kohë të programit, orarit dhe materialeve mësimore, si dhe qasje të barabartë në mësimin përgatitor për të gjithë kandidatët e paraqitur.

4. Ministria e Drejtësisë të inicojë ndryshime në dispozitat që rregullojnë provimin pranues në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, me të cilat provimi do të organizohet në dy pjesë: pjesën kualifikuese, për verifikimin e njohurive juridike, dhe pjesën praktike, për vlerësimin e aftësisë për zbatimin e tyre në praktikë. Pjesa praktike të përfshijë hartimin e një vendimi gjyqësor ose të një akti akuzues, bazuar në lëndë gjyqësore të përfunduara (ad acta), si dhe një intervistë të strukturuar. Për vlerësimin të përcaktohen paraprakisht kritere të publikuara, një sistem unik i pikëzimit dhe procedura të standardizuara, me qëllim sigurimin e një procesi objektiv dhe transparent të përzgjedhjes së kandidatëve, bazuar në aftësitë e tyre analitike, juridike dhe praktike.

5. Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë të vendosë një model fleksibil të trajnimit fillestar, me plane individuale të të nxënit, të përshtatura sipas njohurive paraprake dhe përvojës profesionale të kandidatëve, me kohëzgjatje prej 15 deri në 30 muaj. Trajnimi të organizohet në dy faza: faza përgatitore, me kohëzgjatje prej tre muajsh, gjatë së cilës, përmes vetëvlerësimit dhe vlerësimit të kompetencave, do të identifikohen nevojat individuale për trajnim, dhe faza kryesore, me kohëzgjatje prej 12 deri në 27 muaj, me përfshirje më të madhe të mësimit praktik dhe punës me mentorë. Planet individuale të përgatiten nga Akademia në bashkëpunim me kandidatët dhe mentorët, në bazë të kritereve të unifikuara, duke parashikuar përshtatje të veçantë të trajnimit për kandidatët me përvojë paraprake pune në gjykata dhe prokurori publike. Përparimi dhe kompetencat e fituara të monitorohen përmes vlerësimeve periodike, në bazë të të cilave do të përshtatet ecuria e mëtejshme e trajnimit.

6. Pas përfundimit të trajnimit fillestar dhe dhënies së provimit përfundimtar, Akademia e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë t'ua dorëzojë listat e renditjes së kandidatëve Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Gjatë procedurës së përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, të dy këshillat të kryejnë verifikim shtesë të integritetit të kandidatëve, duke përfshirë kontrollin e gjendjes së tyre pasurore dhe vlerësimin psikologjik, në bazë të kritereve të përcaktuara me ligj dhe procedurave të standardizuara. Rezultatet e këtyre verifikimeve të merren parasysh gjatë miratimit të vendimeve të arsyetuara për përzgjedhjen e kandidatëve, duke garantuar transparencë, trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të drejtën për mbrojtje juridike.